



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:203320
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05651510

P.nr.187/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit L. H., për shkak të veprave penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 dhe “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PP/I.nr.586/2021, të datës 21.09.2021, në fillim të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur më datë 02.05.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari, të pandehurit dhe mbrojtëses së tij sipas autorizimit av. L. K. – G., me datë 03.05.2024 mori dhe publikisht shpalli dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

L. H., me nofkën L., nga i ati E. dhe nëna M. e vajzërisë R., i lindur më ... në P., me vendbanim në Rr. “N. H.” fshati O., Komuna P., me qëndrim në Gj., me numër personal të identifikimit ... , ka të kryer shkollën profesionale, me profesion elektrikist, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I. Me datë 09.07.2021, rreth orës 17:00, në rr. “N. H.”, në fshatin O. KKP., pjesëtarët e policisë, në shtëpinë e të pandehurit L. H., kanë konfiskuar armën e tipit ... , nr. ... , cal. ... mm, ... (...) karikator, ... (...) fishekë gasi dhe ... (...) gëzhoja të të njëjtës armë, të cilat i pandehuri i ka mbajtur në pronësi në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët.

- me këtë ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

II. Të njëjtën ditë, kohë dhe vend si në dispozitivin e parë, i pandehuri në shenjë gëzimi për nisjen e shtëpisë së vëllait të tij, ka përdorë armën e lartcekur me të cilën armë ka shtëndë dy herë në ajër.

- me këtë ka kryer veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

Në kuptim të nenit 76 par. 1 të KPRK-se, të pandehurit:

I P È R C A K T O N

- Për veprën penale si në ikën (I) i shqipton Dënim me Gjobë në shumë prej treqind (300) Euro.

- Për veprën penale si në pikën (II) i vërteton Dënimin me Burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet me Dënim me Gjobë në shumë prej katërqind (400) Euro.

Andaj gjykata në bazë të neneve 76 par. 2 nën-par. 2.4 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe neneve 322, 364, 367, 449 par. 2 nën-par. 2.6 dhe 452 par. 1 të KPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

- I. ME DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej shtatëqind (700) Euro, të cilin dënim detyrohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë.
- II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në shumën dhe brenda afatit të përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.
- III. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale – për paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.
- IV. KONFISKOHET një armë e zjarrit – pistoletë e tipit ... , nr. ... , cal. ... mm, ... (...) karikator, ... (...) fishekë gasi dhe ... (...) gëzhoja të të njëjtës armë, si mjete të kryerjes së veprës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.586/2021, të datës 21.09.2021, kundër të pandehurit L. H., për shkak të veprave penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 dhe “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata në kuptim të nenit 280 të KPPRK-së ka caktuar kohën për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, ashtu që pas hapjes së seancës, shpalljes së çështjes për gjykim, pasi që i pandehuri hoqi dorë nga leximi i aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, të njëjtit në kuptim të nenit 321 par. 1 të KPPRK-së, i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprimet e tij, rasti ka ndodhur për shkak të një gëzimi familjar, arma ka qenë me gas, nga gjykata ka kërkuar që t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj pasi çmoi dhe vlerësoi se kërkesat e parapara me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 të KPPRK-së janë përmbushur, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ngase pranimi i fajësisë është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe dispozitat ligjore të KPPRK-së, propozoi që pranimin e fajësisë gjykata ta aprovoj.

Mbrojtësja e të pandehurit av. L. K. – G., në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështetë deklarimin e të mbrojturit të saj lidhur me pranimin e fajësisë, i njëjti i vetëdijshëm lidhur me benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pas konsultimit me të si mbrojtëse, me vullnetin e tij pranoi fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, gjykatës i propozoi që ta aprovoi pranimin e fajësisë nga i njëjti dhe me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh rrethanat ligjore lehtësuese të parapara me nenin 70 të KPRK-së, për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, armën e ka përdorur në shenjë gëzimi familjar, i njëjti nuk ka qenë në dijeni se përdorimi i armës me gas përbën elemente të veprës penale, andaj nga arsyet dhe rrethanat e sipërtheksuara nga gjykata kërkoi që ndaj të pandehurit t'i aplikojë dispozitat për zbutjen e dënimit në përputhje me nenin 71 par. 1 nën-par. 1.3 dhe nenin 72 të KPPRK-së, të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

I pandehuri L. H. në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të mendimit prokurorit të shtetit, të dëmtuarës dhe mbrojtëses së të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprave penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni

366 par. 1 dhe “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes lidhur me llojin e sanksionit penal, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimet e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, është mbajtës i vetëm i familjes, prind i dy (2) fëmijëve, është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, andaj duke i vlerësuar këto rrethana gjykata aplikoi dispozitat për zbutje të dënimit nën kufirin e paraparë ligjor dhe ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, me bindje se një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë në kryerjen e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Për veprën e parë penale si në pikën (II) “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 par.1 të KPRK-së, parashihet dënimi me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Konform nenit 71 par. 1 nën-par. 1.3 të KPRK-së është përcaktuar se: “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit “... në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”.

Konform nenit 72 par. 1 nën-par. 1.5 të KPRK-së: “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim: “...nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”.

Konform nenit 44 par. 1 të KPRK-së “Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar”.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë me pëlqimin e të dënuarit është marr në kuptim të nenit 44 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin e armës është marrë në bazë të nenit 367 par. 3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr. 187/23, datë 03.05.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.